



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Në bazë të nenit 18.1 dhe nenit 19.2 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149, në përputhje Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Fushë-Kosovës shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

- I. Titulli i pozitës:** Zyrtar për Ndërtimtari
Lloji i pozitës: I karrierës
Nr.Referencës : RN00005316
Vendi i punës: Komuna e Fushë-Kosovës
Orët e punës: 40h në javë
Koeficienti : 7
Raporton tek: Udhëheqës i Sektorit të Urbanizmit

Qëllimi i postit: Që të mbikëqyrë realizimin e projekteve të përgatitura, në mënyrë që puna të kryhet me sukses dhe në bazë të projektit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Hartimi i planit të punës, rishikimi i vitit paraprak, evidentimi i sfidave si dhe eliminimi i tyre për vitet në vijim.
2. Hartimi i projekteve ideore sipas kërkesave, pranimi i kërkesës për projektim.
3. Analizë e detajuar e projekteve, kontrollimi i lëndëve sipas Ligjit për Ndërtim.
4. Hartimi i projekteve ideore sipas kërkesës së udhëheqësit të shërbimit, punimi i projekteve sipas prioriteteve, kontrollimi i dokumentacionit për projekte, ruajtja e dosjeve si fizike po ashtu dhe elektronike.
5. Mbikëqyrja e punimeve të projekteve në vendpunishte.
6. Kontrollimi i cilësisë së punëve, kontrollimi i materialit, evidentimi i vendpunishteve dhe kontrollimi periodik i punimeve, evidentimi dhe raportimi për kualitetin e punës në vendpunishte.
7. Raportimi i shkeljeve të mundshme në projekte nga punëkryesi.
8. Pëlqimi për përfundim të punimeve në projekt.

Edukimi, eksperiencia, shkathtësitë kyçe,

- Diplomë Universitare, Inxh. i Ndërtimtarisë – Konstruktiv ose Arkitektures .
- Të ketë së paku 2 vite përvojë pune.
- Njohja e programeve kompjuterike Word, Excel, Autocad, Power Point, Access;



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Për arsye të numrit të madh të aplikusve vetëm kandidatët e përzgjedhur për listën e ngushtë do të kontaktohen .

Afati i paraqitjes së dokumentacionit është 15 ditë kalendarike, nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga 31.07.2019 deri më 14.08.2019
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë për aplikim dhe ato të pakompletuara nuk do të pranohen.

Dokumentet e kërkuara –Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:

- Kopja e letërnjoftimit,
- Diploma e Fakultetit (e noterizuar),
- Dëshmi mbi përvojën e punës,
- Vërtetimi që nuk është nën hetime, si dhe dokumentet tjera të kërkuara sipas kushteve të konkursit.

Kandidatët e interesuar mund t'i marrin aplikacionet çdo ditë pune, nga ora 09:00 deri në ora 15:00, në Zyrën e Arkivit në ndërtesën e Komunës.